

**GJERGI  
FISHTA**

**JUDA  
MAKABE**

**O PERËNDI A NDJEVE?  
TRATHTARËT NA LANË  
PA ATDHE**

BIBLIOTEKA

2.H-3  
F.65



854-2

F 65

**GJERGJ FISHTA**

# **JUDA MAKABE**

**Fugit impius nemine persequente**

**- Prov. XXVIII -**

**Tragjedi me tre akte**

**Përgatitur nga Tonin Çobani**

BIBLIOTEKA E  
BASHKIS ÇAIROKASTËR

NR INV

55158

**E B " LISITAN "**

© Enti Botues "Lisitan" 1995

Tel. (+355 34753) 412

Reçensentë:

**P.Konrad Gjollaj**

**Tef Topalli**

Përkujdesja grafike:

**Suad Barbullushi**

Shtypshkronja "Gjergj Fishta" Lezhë

# KUR NISTE NJE TRAGJEDI

Nga letra e Gjergj Fishtës dërguar nga  
Shkodra At Pal Dodajt me 20.1.1911

"... Nuk e di sa do të ishte e vertetë për konceptet e tua biologjike lidhja e pozicionit të trurit me diafragmën e kungullit tonë, të quajtur me ironi kokë, e veçanarisht me atë të poetëve; por e di mirë se truri im nuk është taman në skuadër. Një ditë mbrapa, pasi u pata dhënë fjalën disa zotërinjve sqimatarë për të shkruar e shfaqur gjatë kar-navaleve që vijnë një dramë origjinale në pesë akte, e kam humbur krejt fillin. Të them të drejtën, asnjëherë nuk kam patur një shqetësim të tillë.

Kam një dëshirë të zjarrtë që ta mbaj fjalën, por, nga ana tjetër, do të më vinte keq nëqoftëse do të më duhej ta shkruaja turravrap. Kam frikë se teknikisht do ta lë për të dëshiruar këtë punim timin, të parin në një gjini të tillë.

Tema është: **Makabejtë për altar e vatër**<sup>1)</sup>, një argument mjaft i përshtatshëm për problemet tona kombëtare; nuk do të kisha pse të riprodhoja jetën tonë dhe ndjenjat

---

1. "I MACCABEI pro aris et focis" kështu mendonte Fishta ta titullonte në fillim tragjedinë "Juda Makabe".

tona, për të bërë një kryevepër.

Sot mbaroj aktin e parë e, megjithëse nuk e ka gjallërinë që unë shpresoj ta kenë të tjerët, në përgjithësi do të jetë i pëlqyer.

Por jam gjetur shumë ngushtë me kohën për të arritur në përfundim të një pune të tillë në pak javë. Natën nuk mund të shkruaj, sepse bën ftohtë; ditën sa në kishë, sa në shkollë e me shqetësime të vazhdueshme të të tjerëve, mund të punohet shumë pak. Ti e di se prej tre vitesh unë i jam vënë studimit të dramaturgjisë e veçanarisht Shekspirit; nëqoftëse nuk do të dështoj në këtë provë të parë, të jesh krejt i sigurtë se pas ndonjë viti unë do të shkruaj edhe një tjetër. T'i them këto gjëra që të kuptosh se ti je një shpifës kur më quan dëmbel e kur përshkruan me dhimbje hesh-tjen time. E kuptove?... “

*(Nga libri "At Gjergj Fishta", T. 1941, përktheu T.Ç.)*

## JUDA MAKABE

### PERSONAZHET

**Juda**  
**Simeoni**  
**Jonathas** } *Makabejt*<sup>1)</sup>

**Eupolemi**  
**Jasoni**  
**Alkimi**  
**Aminadabi**  
**Ismaeli** } *Kren t'Israelit*<sup>2)</sup>

**Nji Prift** (*burrë i motshem*)

**Abner** (*djalë 13 vjetsh*)

**Bakides**, *Kapitan i Asyrvet*<sup>3)</sup>

**Valle, Popull, Ushtarë** *qi flasin e të tjerë*  
*qi nuk flasin.*

(Ngjarja ndodh në Palestinë)

---

1. Makabejtë ishin fise të lashtë në Jude.

2. Krenë të Izraelitëve.

3. Asirasve, sirinëve të sotëm.

# **AKTI I**

*- Para tempullit të Salomonit -*

## **SKENA I**

**(Juda, Simeoni, Prifti, Eupolemi, Popull, Valle)**

### **Vallja**

O ju popuj e fise t' njerzimit,  
Lavde Zotit kendoni nji zanit;  
Vallë-valle brohritni prej gzimit:  
M'tokë anmikun i Lumi na shtroi  
Sot mbi vise të blerta t'Jordanit  
Prap Liria, si motit, vegoi.

### **Juda**

Qe kшту pra vllazen, sot të bijt' e Abramit <sup>1)</sup>  
Zot shpijet janë n'shpi t'vet. Anmiku i prujtun, <sup>2)</sup>

1. Të bijtë e Abrahamit janë quajtur judejtë.
2. i poshtër.

Qi fen' e Atmen pa njerzi na shkeli,  
 Ai sot prej nesh u thye,  
 E t' lirë, mbas ditës s' sotit  
 Si t' duem na mund t' sherbejmë Atdheut e Zotit  
 O i bukri i qiellvet t' epra, <sup>1)</sup>  
 Ty lavdi t' kjoftë <sup>2)</sup>, e ndera  
 Qi prej verigash <sup>3)</sup> t' prujtuna  
 Na pshtove <sup>4)</sup> edhe nji hera;  
 E t' huejt nen kambë na i vune,  
 Lirin' edhe na prune .  
 Qi lanë të Parët na kan'.  
 N' zi eshten <sup>5)</sup> shpia e tempulli,  
 Ku nuk sundon Liria;  
 E shuhet gjaja e populli,  
 Ku e t' huejve urdhnnon lakmia  
 Me thember t' huej mbi krye,  
 Njeri nuk shef me sy,  
 Te gjallët nuk ka shka e ban.

## Jason

Po, p' r ato vise t' mjera,  
 Ku shklet <sup>6)</sup> i huej pa droje,  
 Nuk ka pse del Prendvera,  
 Bylbyli s' ka pse kndon.  
 Atje si n' vorr shkon jeta;  
 Gjak rrjedhin lume e prroje;  
 Rrogtar mbi troie t' veta,

---

1. i qiejve të lartë.  
 2. qoftë.  
 3. zingjirsh.

4. shpëtove.  
 5. rënkojnë.  
 6. shkel, ec.



Kurr njeri atje s'lumnon.

## Prifti

Der sa mbi kobe t'shekullit  
T'u endë t'shkojë rrezja e diellit,  
Emni i atyne fatosavet  
Kjoftë bekue nalt prej qiellit,  
Qi per Liri të vllazenvet  
Iu bane flie Atdheut:  
E sa hana - e malet t'tana  
Rrnofshin " t'bijt' e Makabeut!

## Vallja

E sa hana - e malet t'tana  
Rrnofshin t'bijt' e Makabeut!  
Njiksi djelmsh nuk ban ma nana  
Kahdo t'bjere dielli dheut.  
Njiky Juda Makabe  
N'ballë t'anmikut kur po del,  
Shpata e tij veton si rufe,  
Gjimon fusha me zabel.  
Apoloni <sup>2)</sup>, kapitani,  
Israelit luftë po i qet:  
Njiky Juda, porsi ulani <sup>3)</sup>,  
Me nji t'sjellme kryet ia pret.  
Shpata e Judes, si vetima,

1. rrofshin.

2. Emri i njërit prej kryekomandateve  
të ushtrive armike të mundur prej

Judës Makabe.

3. luani.

Kah dhetëmijë <sup>1)</sup> n'nji ditë i preu:  
Brohoritni djelm e trima:  
Rrnofhtë Liria e Makabeu!

## Populli e Vajlja

Rrnofhtë Liria e Makabeu!

### Juda

O vllazen, nderës prej zemëret  
Na Makabejt' po u falëna,  
Per kto ndjesi të bukura,  
Qi po na i shprehni n'gzim.  
Per me u dalë zot të drejtave  
T'Atmes e t'Fes' të shkeluna,  
Nder lufta t'forta e t'ashpera  
Çdo burrë bjen pa hutim.

Kush di n'shekull shk'a(sht) <sup>2)</sup> ndera e burrnia,  
Per Fe shejte, per Atme të bekueme  
Atij jeta s'i dhimbet, as shpia,  
Duhmja e ferrit udhës hovin s'ia pret:  
Kosa e dekes si pret shemtueme,  
N'dorë t'tij shpata ashtu anmikun e pret.

### Eupolemi

T'gjallët e Lirin' e popullit  
Mbarë Atmja shejte e Evrejve  
Në dorë ju Makabejve

1. dhjetëmijë.

2. shka a, ç'asht, çfarë është.